



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 4329/ Prot.

Tiranë, më 22 . 11 2019

Lënda: *Kërkesë për informacion.*

Drejtuar: Zonjës Naureda LLAGAMI
KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Zotit Gent IBRAHIMI
KRYETAR I KËSHILLIT Ë LARTË TË PROKURORISË

Për dijeni: Zonjës Erinda BALLANCA
AVOKATI I POPULLIT

TIRANË

Të nderuar,

Pranë Institucionit të Presidentit të Republikës është administruar shkresa e Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 5693 prot., datë 15.11.2019 “Dërgimi i listës me emrat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, të gjykatave administrative, të cilët plotësojnë kushtet e parashikuara në ligj për t`u përfshirë në shortin për anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, protokolluar me tonën nr. 4329 prot., datë 15.11.2019.

Gjithashtu, është administruar shkresa e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr. 901 prot., datë 15.11.2019 “Dërgohet lista e prokurorëve që plotësojnë kushtet për të qenë anëtar i Këshillit të Emërimeve për Drejtësi”, protokolluar me tonën me nr. 4328 prot., datë 15.11.2019.

Në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në nenin 221, konkretisht në pikat 4, 5 dhe 6, përveç të tjerave, përcaktohet se:

“4. Lista me kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet bëhen publike në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.

5. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyvetuar për shkaqet e përjashtimit. Ata mund të ankohen brenda 5 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.”

Në kushtet kur, kjo dispozitë saktëson kriteret dhe procedurat e aplikueshme nga institucionet tuaja për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që më pas i paraqesin ato pranë Presidentit të Republikës, në mbështetje të nenit 92 germa h të Kushtetutës, kërkojmë të informohemi nga ana juaj nëse:

1. Janë bërë publike nëpërmjet faqes zyrtare të institucioneve që ju drejtoni lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të KED-së dhe lista e kandidatëve që nuk i plotësojnë këto kushte?
2. Është kryer procedura e njoftimit me shkrim të kandidatëve të përjashtuar për shkak të mosplotësisimit të kushteve për kandidat të KED-së?
3. Ka patur ankesa pranë Gjykatës Administrative të Apelit për vendimin e marrë nga institucioni juaj nga ana e gjyqtarëve /prokurorëve të cilët janë përjashtuar nga kandidimi?
4. Ka vendime përfundimtare dhe të formës së prerë nga Gjykata Administrative e Apelit për ankimet e kandidatëve të përjashtuar nga institucioni juaj, për anëtar të KED-së?

Me qëllim përzgjedhjen e rregullt dhe sipas parashikimeve Kushtetuese dhe ligjore të përbërjes së institucionit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësisë, kërkojmë që informacioni mbi procedurat e ndjekura nga institucionet që ju drejtoni të përcillet në një kohë të shpejtë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës si dhe për dijeni Avokatit të Popullit, si organ monitorues i procesit të përzgjedhjes me short të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Duke vlerësuar maksimalisht, procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, informacioni paraparak i kërkuar vlerësohet i nevojshëm.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ornela ZONJA

